



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Ndërmarrjet Publike.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Koncept Dokumentit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

KONCEPT DOKUMENTI PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

Kapitulli 1

Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes dokumenteve strategjike të miratuara deri më tani, synon përmirësimin e performancës së Ndërmarrjeve Publike, rritjen e vlerës së aseteve si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për publikun. Harmonizimi dhe zbatimi i parimeve themelore të qeverisjes korporative, siç janë korniza e pronësisë, mekanizmi monitorues efektiv, funksionimi efikas i Bordeve të NP-ve, raportimi dhe integriteti, fuqizimi i rolit të Aksionarit ndaj NP-ve, auditimi financiar, menaxhimi i riskut karshi objektivave dhe planeve të parapara dhe faktorëve të pa-parashikueshëm, transparenca dhe llogaridhënia, marrëdhënia me aksionarët dhe akterët tjerë, janë parakusht për realizimin e objektivave të NP-ve.

Dokumentet që ndërlidhen me konceptin për Ndërmarrjet Publike:

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018 në shtyllën 1. **zhvillimi ekonomik, punësimi dhe mirëqenia** tek pika 1.13. Përmirësimi i performancës së ndërmarrjeve publike, parasheh që Qeveria do të forcojë qeverisjen kooperative të përgjegjshme dhe profesionale, që siguron qëndrueshmëri të ndërmarrjeve publike, dhe cilësi të lartë të shërbimeve për qytetarët. Me qëllim të përmirësimit të performancës së ndërmarrjeve publike Qeveria do të rishikoj bazën ligjore dhe arsyeshmërinë që i ndan ndërmarrjet publike në qendrore dhe lokale, për të siguruar se në vendimmarrje të këtyre janë të përfshirë aktorët që janë të prekur nga veprimtaria e këtyre ndërmarrjeve.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021) – Shtylla 3, Masa 24 parasheh që përmes këtij dokumenti Qeveria do të përmirësojë efikasitetin e ndërmarrjeve publike në përputhje me parimet e qeverisjes korporative të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE).

Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim dhe Asociimit (PKZMSA) 2017-2021- Ndërmarrjet Publike trajtohen tek Politikën e konkurrencës dhe Ndihmën Shtetërore. Një ndër kërkesat e MSA-së është që Kosova të aplikoj rregullat e BE-së për ndihmë shtetërore përfshirë përjashtimet në bllok, ndihmën de minimis, shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik, dhe rregullat e transparencës për ndërmarrjet publike.

Programi për Reforma Ekonomike - Në kuadër të këtij programi, Qeveria do të konsiderojë mundësitë për qasje sektoriale të monitorimit dhe menaxhimit të korporatave

me pronësi publike. Përveç kësaj, mungesa e një procesi të duhur për analizë të rrezikut të ndërmarrjeve shtetërore për buxhetin dhe ekonominë rezulton me një zhvillim të dobët të ndërmarrjeve.

Plani Vjetor i Punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2017, me këtë plan është përcaktuar hartimi i Koncept Dokumentit për Ndërmarrjet Publike në periudhën Janar – Dhjetor 2017, i cili është përfshirë edhe në listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2017.

Kapitulli 2

Përshkrimi i çështjes / Problemit kryesor

(kohëzgjatja dhe permasat e problemit/qështjes)

Ndërmarrjet Publike, nga viti 1999 kanë qenë nën mbikëqyrje të UNMIK-ut, ndërkaq pas themelimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, në qershor 2002, ato u vendosën nën menaxhimin e saj. AKM-ja ka korporatizuar të gjitha NP-të (gjithsej 25) që i kishte në portfolio dhe kishte formuar një strukturë të re të qeverisjes korporative. Qeveria mori në pronësi Ndërmarrjet Publike më 1 korrik 2008 (me perjashtim të KEK).

Aktualisht të gjitha Ndërmarrjet Publike janë të organizuara si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare. Ndërmarrjet Publike Qendrore në Kosovë janë në pronësi të Republikës së Kosovës konform ligjit për ndërmarrjet publike në fuqi, ndërkaq të gjitha NP-të Lokale janë në pronësi të komunës ose komunave, dhe përqindja e pronësisë së secilës komunë është e përcaktuar në dispozitat e ligjit për ndërmarrje publike në fuqi. Qeveria ka kompetencat ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit në Ndërmarrjet Publike të nivelit qendror (përpos ndërmarrjes Trepça Sh.A e cila rregullohet me Ligjin 05/L-120), ndërsa kompetencat ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit në nivelin lokal i takojnë Komunave përkatëse.

Një ndër problemet e identifikuar deri më tani në funksionimin e NP, është fakti që Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka ndonjë strategji **afatgjate** për menaxhimin e aseteve të saj. Sipas ligjit në fuqi, Qeveria është e obliguar të miratojë një politikë të pronësisë. Me gjithë rëndësinë tepër të madhe që ka ky dokument i politikave të pronësisë, duke qenë se nga këtu buron e gjithë politika mbi ndërmarrjet publike, vlen të theksohet se nuk ka specifikim të qëllimit të këtij dokumenti, kushtet dhe kriteret e rishikimit të tij, si dhe përcaktimi i objektivave për natyrën e veçantë të ndërmarrjeve të fushë-veprimtarive dhe llojeve të ndryshme të ndërmarrjeve. Dokumenti i politikave të ndërmarrjeve është miratuar në vitin 2008 nga Qeveria dhe nga atëherë nuk është bërë rishikimi i tij apo të paktën nuk është diskutuar se nevoja për këtë.

Një nga parimet e OBZHE-së përfshinë identifikimin e politikave pronësore si dhe objektivat e NSH-ve. Prandaj shteti (apo Aksionari) duhet të krijoj kornizën e Politikave të Pronësisë Shtetërore (PPSH), ku ndër të tjera, do të përcaktohet arsyeshmëria e përgjithshme për pronësinë e shtetit mbi NP, rolin e shtetit në qeverisjen e NP-ve, se si do të zbatohet shteti politikën e pronësisë dhe rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të akterëve qeveritarë të përfshirë në zbatimin e saj. Politika e pronësisë duhet t'i nënshtrohet procedurave të përshtatshme të përgjegjësisë politike dhe të prezantohen tek publiku i gjerë. Qeveria duhet të shqyrtojë në intervale të rregullta politikën e saj të pronësisë mbi NP, të përcaktojë arsyet për posedimin e çdo NP-e dhe t'i nënshtrojë ato rishikimit periodik.

Bazuar në Politikën e Pronësisë Shtetërore (PPSH), NP zhvillojnë strategjitë e tyre individuale të dalta nga Bordi Menaxhues i NP, të cilat i nënshtrohen miratimit nga Bordi i Drejtoreshave të NP. Strategjitë e NP, ndër tjerash duhet të përfshijnë planet afatmesme apo afatgjata të NP, identifikimin e objektivave zhvillimore të ndërmarrjes, sfidat dhe rreziqet në realizimin dhe implementimin e strategjisë si dhe buxhetin/kornizën financiare për realizimin e Strategjisë. Indikatorët e performancës të përcaktuar në Strategjinë e NP, ndër tjerash i shërbejnë shtetit (Aksionarit) për të monitoruar dhe vlerësuar Bordin e Drejtoreshave në realizimin dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara nga NP.

Lidhur me krijimin e kornizës së *përformancës*, mbetet sfida për Qeverinë, fakti që NP-të krijohen dhe mbesin në pronësi shtetërore për të përmbushur objektiva komerciale dhe jo-komerciale. Në shumë raste objektivat dhe caqet jo-financiare bartin në vete kosto financiare, fakt ky që krijon vështirësi shtesë për të vendosë prioritetet kundërthënëse. Asimetria e informacionit është rrethënë shtesë vështirësuese për të përcaktuar drejtë elementet e *monitorimit të përformancës*. Vendosja e kornizës adekuate institucionale për matje dhe monitorim të përformancës kërkon kapacitete dhe ekspertizë të mjaftueshme si dhe koordinim të ngushtë në mes të pronarit dhe NP-ve. Ekspertiza është me rëndësi të jetë edhe në aspekt të sektorëve në të cilët operojnë NP-të (organizimi sektorial i njësisë dhe pjesëmarrja e departamenteve sektoriale në faza të ndryshme të monitorimit të përformancës). Problem mbetet edhe mos posedimi i një strategjie nga ana e secilës nga NP-të, strategji të cilat do të kishin për qëllim ndër tjerë edhe matjen e përformancës. Mungesa e strategjisë e bën të vështirë matjen e performancës operative dhe financiare të Ndërmarrjeve Publike. Kur kemi rastet e objektivave të ndryshme të cilat mund të jenë kundërthënëse në aspekt të politikave dhe aspektit komercial, ato duhet të identifikohen shumë qartë.

Sa i përket *transparencës dhe llogaridhënies*, mund të konsiderohet se nuk ka transparencë të mirëfilltë nga ana e Bordit në raport me Aksionarin. Gjithashtu, problem

paraqitet mos publikimi i rregullt i raporteve financiare nga ana e NP-ve, me standardet e përcaktuara ndërkombëtare. Lidhur me këtë, konsiderohet se nuk janë transparente kualifikimet e anëtarëve të bordit, procesi i përzgjedhjes, pagat, shpërblimet, kompensimet dhe tjera. Në ligjin për Ndërmarrjet publike, transparenca është mjaftueshëm e mbuluar me Nenin 7, mirëpo paqartësitë e detektuar në këtë Nen e bëjnë të pamundshëm implementimin e plotë të tij si dhe qasjen e aksionarit dhe publikut në informata të sakta mbi kompaninë. Mangësitë që dalin nga implementimi i këtij Neni e bëjnë të pamundur realizimin e plotë të këtij parimi dhe rrisin tendencën që ndërmarrjet publike të fshehin fakte të padëshirueshme.

Tek *raportimet* vjetore të NP-ve, është vërejtur mungesa e përfshirjes së aspekteve mjedisore dhe aspekteve sociale (posaçërisht tek kompanitë e sektorit energjetik). Në anën tjetër, nuk është e përcaktuar një standard i përgjithshëm i raportimit për Ndërmarrjet Publike nga ana e Aksionarit, si dhe nuk është i përcaktuar afati për miratimin e raportit për performancën e NP-ve në Kuvend. Për më tepër, raportimet mujore, vjetore të parashikuara në legjisllacionin në fuqi, nuk gjejnë zbatueshmëri në praktikë nga NP-të. Mangësitë: Disa parametra në raportet e NP-ve janë të pasakta pasi që kur të analizohen ato, raportet e zyrave rregullatore ndryshojnë nga raportet e NP.

Nuk është e definuar qështja e *menaxhimit të riskut* në raportet vjetore të NP-ve. Menaxhimi i Rrezikut është një proces i zbatuar nga Bordi i NP-ve për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet që janë mbi nivelin e tolerancës së rrezikut, në nivele të cilat nuk paraqesin kërcënim për arritjen e objektivave të organizatës. Ndërmarrjet Publike janë përgjegjëse për implementimin e procedurave të tyre për identifikim, vlerësim dhe zvogëlim të rrezikut. Menaxhimi i rrezikut nga ana e Bordit të Drejtorëve do të përmbante në vete objektivat si mbrojtja e interesave financiare, siguria e përmbushjes së objektivave, mbrojtja e burimeve njerezore, hartimi i nje plani alternativ i cili nuk dëmton direkt operimin e Ndërmarrjeve.

Poashtu është paraqitur si mangësi mungesa e dispozitave *korrigjuese dhe ndëshkimore* andaj, lidhur me këtë çështje, duhet të kërkohet një modalitet që mos raportimi dhe pa saktësia e të dhënave të sanksionohet me ligj.

Politika aktuale

Ligji në fuqi për ndërmarrjet publike ka për qëllim përcaktimin e kornizës ligjore lidhur me pronësinë e Ndërmarrjeve Publike me ç'rast ka përcaktuar edhe ushtrimin e të

drejtave të aksionarit, zgjedhjen e bordeve të drejtoreve, menaxhmentin dhe detyrimet e tyre.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik përmes Njesisë për Politikat dhe Monitorimin e NP-ve (“Njësia për NP”) është përgjegjëse për sektorin e ndërmarrjeve publike përmes Ligjit për Ndërmarrjet Publike, me qëllim të mbështetjes së Ministrisë dhe Qeverisë në ushtrimin e përgjegjësisë për NP-të të cilat u janë dhënë atyre me këtë ligj.

Komisioni Ndërmarrës për NP-të, që përbëhet nga ministrat përkatës, MZHE si kryesuese dhe MF, MMPH, MI dhe MTI anëtarë. Ky Komision shqyrton çështjet kryesore që kanë të bëjnë me NP-të, me qëllim të përgatitjes së debatit në Qeveri.

Qeveria i përgjigjet Kuvendit për mënyrën në të cilën ajo, Ministri dhe Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP-të i ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë të cilat u janë dhënë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kompetencë shqyrtimin dhe miratimin e raporteve vjetore të secilës NP.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Aksionari) që të përfaqësojë të drejtat e aksionarit në NP-të përkatëse. Bordi është përgjegjës për drejtimin e planeve të Ndërmarrjes por nuk e menaxhon Ndërmarrjen. Bordi duhet të identifikojë biznesin dhe konkurrencën e tij, të fokusohet në problemet strategjike dhe menaxhimin e rrezikut dhe të themelojë standarde të larta të performancës duke përfshirë sjelljet etike si dhe performancën operative dhe financiare.

Komisioni i Auditimit përzgjedhet nga Ministri për Zhvillim Ekonomik dhe ky komision në një NP ka të drejtë ekskluzive për përzgjedhjen e Auditorit të Brendshëm.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligji bazë për Ndërmarrjet Publike në Republikën e Kosovës është Ligji Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike (GZ Nr.31/15qershor 2008). Ky ligj përcakton kornizën ligjore lidhur me pronësinë e Ndërmarrjeve Publike dhe qeverisjen e tyre korporative në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të Ndërmarrjeve Publike.

Ligji Nr. 04/l-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/l-087 për Ndërmarrjet Publike- Qëllimi i të cilit ka qenë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit bazik për NP-të dhe rregullimi i disa çështjeve që janë paraparë si problem dhe nuk kanë gjetë zbatim të mjaftueshëm me Ligjin bazik për Ndërmarrjet Publike.

Ligji nr. 05/L -009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjin nr. 04/l-111(GZ/ Nr. 10 / 07 maj 2015)- Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për

Ndërmarrjet Publike, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.31, 15 qershor 2008.

Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (GZ. 39/01 Tetor 2008) - Qëllimi i këtij ligji është që të përcaktojë llojet e shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë tregtare në Kosovë; të caktojë kushtet e zbatueshme të regjistrimit, për secilin lloj të shoqërive tregtare; të përcaktojë, për secilin lloj të shoqërive tregtare, dispozitat ligjore për kapacitetin dhe strukturën juridike si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, menaxherëve, drejtorëve, përfaqësuesve juridik dhe palëve të treta; dhe të përcaktojë dispozitat ligjore të cilat nxisin dhe lehtësojnë themelimin, funksionimin dhe shpërbërjen e rregullt dhe efektive të shoqërive tregtare.

Ligji Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (GZ. 6/22 Korrik 2011)- Qëllimi i të cilit ka qenë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit bazik për Shoqëritë Tregtare dhe rregullimi i disa çështjeve që janë paraparë si problem dhe nuk kanë gjetë zbatim të mjaftushëm me Ligjin bazik për Shoqëritë Tregtare.

Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (GZ. 27/03 Qershor 2008) –dhe të gjitha ndryshim plotësimet e tij.

Në zbatim të Ligjit për NP, janë nxjerrë këto akte nënligjore:

Rregullore Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit- Kjo Rregullore përcakton kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, me qëllim të qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike që veprojnë në komuna. Dispozitat e kësaj Rregullore përcaktojnë kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale; dhe pjesëmarrjen e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit.

Rregullore (QRK) Nr. 19/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit- Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit.

Udhëzimi Administrativ Nr.03/2009 për mënyrën e përfaqësimit të komunave në Bordet e Drejtorëve të NPL - Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i menyrës së përfaqësimit të komunave në bordet e drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale.

Rregullorja mbi Punën e Komisionit të Ministrave për Ndërmarrje Publike (2011)- nr. prot. 1674 i datës 28.09.2011, nxjerrë nga Kryesuesi i Komisionit për NP dhe njeherish Ministri i Zhvillimit Ekonomik- Qëllimi i kësaj Rregullore të punes, është rregullimi i përbërjes së Komisionit të Ministrave për Ndërmarrjet Publike (ne tekstin e mëtejme KMNP), përcaktimi i detyrave dhe përgjegjesive të anetareve, si edhe mënyra e vendimmarrjes dhe raportimit.

Dokumentet tjera:

Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat Pronësore për Ndërmarrje Publike - miratuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.11/39 i datës 08.10.2008.

Procedurat për mbikëqyrjen dhe monitorimin e Ndërmarrjeve Publike Qendrore- me nr. Prot.238 i datës 09.02.2012 nxjerrë nga Drejtori i NJPMNP.

Legjislacioni sektorial:

Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina (GZ. Nr.17 / 29 Qershor 2012)- Ky ligj ka për qëllim: evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, zhvillimi i qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut, deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (GZ/ Nr. 30 09 NËNTOR 2012,) Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.

Ligji Nr.03/L-173 për Shërbime Postare (GZ. Nr. 69 / 20 Maj 2010)- Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i ofrimit të shërbimit universal postar dhe shërbimeve tjera postare, mbrojtja e interesave të shfrytëzuesve, sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të tyre, nxitja e konkurrencës së lirë dhe efektive në ofrimin e shërbimeve postare, nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit dhe sigurimi i sekretit të korrespondencës për shfrytëzuesit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës(GZ. Nr. 10 / 29 Prill 2013)- Qëllimi i këtij ligji është: të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin

social - ekonomik të Republikës së Kosovës, të themelojë procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzimin dhe qëllimin; të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi' të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Ligji Nr.04/L081 - për Energjinë (GZ. Nr. 24 / 13 Korrik 2016) - Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme përmes të cilave drejtohen veprimtaritë në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me energji, për të krijuar kushte për një treg të hapur funksional, transparent dhe konkurrues, duke promovuar shfrytëzimin më eficient të energjisë, rritjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe bashkëprodhimit, mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet e energjisë dhe veprimet me të cilat krijohen dhe në bazë të të cilave zbatohet politika e energjisë dhe planifikimi i zhvillimit të sektorit të energjisë.

Ligji Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike (GZ. Nr. 26 / 21 Korrik 2016)- Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë rregulla dhe masa për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike, për të garantuar furnizim të sigurt, të besueshëm, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike, me çmime reale, duke pasur në konsideratë ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin efikas të saj.

Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 25/14 Korrik 2016)- Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji,përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.

Ligji Nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës(GZ. Nr. 28 / 16 Dhjetor 2011)- Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit hekurudhor, përmirësimin e sistemit të sigurisë, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit hekurudhor.

Ligji Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (Ligji nr. 03/l-163 për Minierat dhe Mineralet- Qëllimi i këtij ligji është promovimi në përputhshmëri me standardet e pranuar mjedisore, i hulumtimit, nxjerrjes dhe pasurimit të Mineraleve përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimit dhe mbështetja e një pjesëmarrje dhe konkurrence më të madhe të sektorit privat në industrinë minerare, maksimalizimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të Mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore për të mirën e Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-163 për Minierat dhe Minerale(GZ. Nr. 11 / 02 Maj 2013)

-Ligji Nr.06/L-120 për Trepçën (Nr. 36 / 31 Tetor 2016)- Ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore e cila synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes hapjes së rrugës për investime, rritjen e vlerës së aseteve dhe avancimin e kapitalit tekniko teknologjik si parakusht për rivitalizimin e Trepçës si një ndërmarrje me rëndësi të veçantë, jetike për mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e përgjithshëm publik.

Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Kosovës (GZ. Nr. 18 / 19 Shtator 2011)- Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Ligji Nr.04/L-237 për ndryshimin/plotësim të Ligjit për Prokurimin Publik, Ligji Nr.05/L-068 për ndryshimin/plotësim të Ligjit për Prokurimin Publik

Ligji Nr.05/L-092 për ndryshimin/plotësim të Ligjit për Prokurimin Publik

Ligji Nr.04/L-045 për Partneritetet Publiko Private(G.Z. Nr. 26 / 25 Nëntor 2011) - Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kornizës ligjore për partneritet publiko privat duke përfshirë procedurat për të hyrë në një partneritet publiko privat, përmbajtjen dhe strukturën e marrëveshjeve për Partneritet Publiko Privat si dhe strukturën institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e Partneritetit Publiko Privat në Republikën e Kosovës.

Ligji Nr.05/L-100 për Ndhimen Shtetërore (G.Z. Nr. 3 / 17 Janar 2017) – Me këtë ligj përcaktohen parimet dhe procedurat, kushtet e përgjithshme si dhe rregullat për autorizimin, monitorimin dhe revokimin e ndihmës shtetërore.

Ligji Nr. 04/I-063 për Hekurudhat e Kosovës(G.Z. Nr. 28 / 16 Dhjetor 2011)- Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit hekurudhor, përmirësimin e sistemit të sigurisë, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit hekurudhor.

Ligji Nr. 04/I-147 për Ujërat e Kosovës (G.Z. Nr. 10 / 29 Prill 2013)- Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të Republikës së Kosovës, të themelojë procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzimin dhe qëllimin të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujor.

Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr.03/2015 për percaktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga agjencia për regjistrimin e bizneseve.

Udhëzim Administrativ (MF) Nr. 02/2013 për strukturën dhe përmbajtjen e raportimeve financiare vjetrore.

Në zbatim të legjislacionit për NP janë vërejtur shumë mangësi për të cilat nevojitet sqarim dhe definim të çështjeve që kanë qenë pengesë në funksionalizim të NP. Gjithashtu ekzistojnë paqartësi në mes të Ligjit për NP dhe Kodit të Qeverisjes Korporative lidhur me funksionimin e Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Është vërejtur se Rregullorja mbi Punën e Komisionit të Ministrave për Ndërmarrje Publike ende si bazë ligjore për nxjerrjen e saj ka Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën Ekzekutiv të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, gjë që e bën të pazbatueshme dhe jo funksionale dhe duhet të kemi parasysh me miratimin e legjislacionit të ri për NP.

Ligji aktual për Ndërmarrjet Publike nuk i definojnë qartë procedurat që duhet ndjekur me rastin e themelimit të Ndërmarrjeve Publike Qendrore, si rrjedhojë vërehet mungesa e një akti të veçantë nënligjor për këtë çështje.

Dispozitat aktuale të përcaktimit të politikave të pronësisë (Neni 6) janë shumë të përgjithshme. Këto dispozita nuk i japin hartuesit të politikave të pronësisë (Qeverisë) kritere se ku duhet bazuar Qeveria gjatë përcaktimit të Objektivave të përgjithshme të Republikës së Kosovës në lidhje me pronësinë e NP-ve. Ndërmarrjet publike kanë veçori të ndryshme, rrjedhimisht edhe politikat e pronësisë duhet të marrin parasysh këto veçori dhe kjo duhet reflektuar në ligj. Politika pronësore për ndërmarrjet që operojnë në kushte konkurrence dallon nga ajo e ndërmarrjeve që operojnë jashtë konkurrencës tregtare.

Gjithashtu Ligji ka mungesë të dispozitave që përcaktojnë parimet, kriteret dhe përgjegjësitë që lidhen me Komisionin ndërqeveritar si dhe Ministrin.

Ligji duhet të ketë të përcaktuar qartësisht të drejtën e Aksionarit për të dhënë një opinion paraprak para se të miratohet Strategjia përkatëse e çdo NP-je, në mënyrë që të merren parasysh politikat pronësore mbi ndërmarrjet si dhe politikat sektoriale të zhvillimit në mënyrë që paraprakisht të harmonizohen politikat zhvillimore me ato të ndërmarrjeve publike.

Disa nga Problemet ligjore më të detajuara të hasura gjatë zbatimit:

Në Ligjin 04/L-111 është plotësuar Neni 18.1. i Ligjit bazik ku thuhet se: Bordi i Drejtorëve të NP-së do të ushtrojë mbikqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në vecanti të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së, por kjo nuk nënkupton edhe përzjerjen në mikromenaxhim”. Mospërcaktimi më i qartë i kësaj dispozite ka bërë që ndryshimi i tillë të mos ketë efekt, dhe praktikën e tilla të mos eliminohen.

Neni 15 i LNP, përcakton përzgjedhjen e BD me mandat 3-vjeçar dhe skadimi i mandati të BD është i rregulluar në Ligjin për Shoqëri Tregtare ku precizohet se pavarësisht nga skadimi i mandatit deri sa të zgjidhet nga pasardhësi. Kjo në praktikën e deri tanishme ka paraqit vështirësi sepse është krijuar një kohë të pacaktuar ku NP ka mbetur pa një mbikqyrje efektive dhe të vendimarrjes nga BD.

Në LNP, neni 21.1 përcakton zgjedhjen dhe emërimin e zyrtarëve të lartë të NP. Gjatë zbatueshmerisë së ligjit, përkatësisht këtij neni, emërimi i zyrtarëve të lartë nga ana e bordit dhe mundësia që bordi në çdo kohë dhe me shumicë votash të ndërpres kontratën e tyre me ose pa deklarinimin e arsyes; ka hasur në diskriminim dhe presion mbi zyrtarët e lartë.

Në Ligjin 03/L-087 (LNP), neni 21.4, dhe në Ligjin 04/L-111 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 03/L087 për NP, neni 13, përcakton mënyrën e përzgjedhjes së zyrtarëve të lartë nga Bordi i Drejtorëve bazuar në procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese me qëllim të përzgjedhjes së personave në bazë të meritës. Mirëpo, ky nen nuk definon kohëzgjatjen e mandatit të zyrtarëve të lartë dhe po ashtu nuk definon qartë se çfarë procedurash duhet të ndiqen pas skadimit të kontratës së tyre. Në praktikë, mungesa e mosdefinimit të qartë të këtyre çështjeve ka sjellë konfuzitet në përzgjedhjen e zyrtarëve të lartë.

Në Ligjin 03/L087 për NP, neni 12.1 përcakton detyrimet e përgjithshme të NP dhe drejtorëve të saj që fokusohet vetëm në rritjen afatgjate të vlerës së ndërmarrjes dhe aksionarëve. Mirëpo, ky nen nuk parasheh ofrimin e shërbimeve të mirëfillta ndaj qytetarëve si detyrim i përgjithshëm.

Programi aktual

Në programin aktual përfshihen trajnimi i Bordeve të Drejtorëve për Qeverisje Korporative në Ndërmarrje Publike, përmes Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Këto trajnime zhvillohen një herë në vit dhe kanë për qëllim përmirësimin e performancës së Anëtarëve të Bordeve.

Shpenzimet aktuale

<i>Kategoritë e shpenzimeve</i>	<i>Shpenzimet faktike në vitin paraprak</i>	<i>Buxheti këtë vit</i>	<i>KASH për vitin e ardhshëm</i>
<i>Buxheti i Ministrisë:(shëno secilin lloj të shpenzimit) total buxheti i Ministrisë duke përfshi kapitale dhe mallra e shërbime paga mëditje dhe shpronësimet</i>			
<i>Paga dhe meditje</i>	78,819.81	85,813	85,813
<i>Mallra dhe Sherbime</i>	0	0	0
<i>Shpenzimet komunale</i>	0	0	0
<i>Subvencionet dhe Transferet</i>	10,754,755.21	1,800,000 4,270,000	1,800,000 4,270,000
<i>Shpenzimet kapitale</i>	13,137,950.70		

<i>Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)</i>			
<i>Finacimet nga huamarrjet, mallra dhe shërbime dhe kapitale</i>			
<i>Financimi nga donatorët, nga linja mallra shërbime dhe paga mëditje si dhe investime kapitale</i>			
<i>Shpenzimet e drejtëpërdrejtja nga Ministria e Financave</i>			

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale (elemente plotësuese të mos funksionimit të politikës aktuale)

Në dispozitat e ligjit aktual nuk është qartë e cekur se cilat masa të duhura korrigjuese do të ndërmerr aksionari/ët në rast se Bordi i Drejtorëve dështon në realizimin e planeve të biznesit dhe afatin kohor se kur do të merret ky vendim ose masë korrigjuese. Kjo është njëra ndër pikat kryesore e cila e obligon Bordin që të veprojë dhe e determinon të ardhmen e Bordit dhe duhet definuar dhe përcaktuar qartë.

Në Ligjin aktual nuk janë të definuara qartë detyrat dhe obligimet e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Kjo mungesë i ka lënë hapësirë Bordit që të ndërmerr hapa apo kërkoj llogari për çështje të cilat nuk janë në funksionin e tyre.

Pozita e zyrtarëve të lartë është e paqartë sepse sipas Ligjit është përcaktuar që ata i shërbejnë Bordit të Drejtorëve. Mirëpo përzierja e funksioneve të pozitave ekzekutive dhe jo-ekzekutive mund të sjellë tek konflikti i interesit dhe është në kundërshtim me parimin e llogaridhënies (Neni 21).

Shërbimi i katër zyrtarëve për Bordin e Drejtorëve bie ndesh me parimin e mos-përzierjes së Bordit të Drejtorëve në mikromenaxhimin e kompanisë, detyrë kjo e Kryeshefit të

kompanisë apo CEO-s. Kryeshefi i kompanisë jep përgjegjësi për menaxhimin e kompanisë dhe sipas nevojës, kërkon llogari nga drejtorët brenda kompanisë për operimin e brendshëm. Interferimi apo kërkesë për këshillim nga ana e Bordit drejtuar zyrtarëve është konflikt i interesit i cili duhet parandaluar me ligj.

Interesi primar i Aksionarit/ve duhet siguruar përmes monitorimit dhe implementimit të kodit të qeverisjes, aprovimit të pasqyrave financiare, vendimit për dividendë, miratimit të ndryshimeve ligjore/akteve nënligjore apo ndryshimeve në strukturën e kapitalit, emërimet dhe shkarkimet e Bordit, pagesat, shpërblimet dhe kompensimet në të gjitha nivelet e kompanisë.

Kjo për të siguruar që interesi i Qeverisë/Aksionarit është primar dhe që Aksionari ka vendimin final sa i përket çështjeve të rëndësishme të kompanisë. Roli i Aksionarit duhet fuqizuar përmes ligjit të ri, sepse në ligjin aktual roli i tij është pasiv, duke i'a dhënë fuqinë e plotë Bordit të Drejtorëve që të veprojnë në emër të tij.

Ligji nuk e ka saktësuar mënyrën e përfshirjes së politikave sektoriale në politikat e ndërmarrjeve.

Për të ushtruar ndikimin dhe autoritetin e duhur në mbledhjet vjetore të Bordit ku merr pjesë Aksionari, duhet të saktësohet se ky rol nuk mund t'i delegohet dikujt më pak se Ministrit apo zëvendësministrit.

Përvoja në shtetet tjera

Modeli i Sllovenisë

Struktura menaxhuese

Sllovenia ka strukturë sipas dy niveleve të menaxhimit. Aksionarët kanë të drejtë të caktojnë Bordin Mbikëqyrës dhe rrjedhimisht, ky Bord cakton anëtarët e Bordit Menaxhues.

Aksionari mund të shkarkoj Bordin Mbikëqyrës me shumicë të kualifikuar të votave, në rast se nuk ka arsye dhe me shumicë të thjeshtë në rast të arsyes. Anëtarët e Bordit Menaxhues mund të shkarkohen vetëm me arsye nga ana e Bordit Mbikëqyrës. Vota e mosbesimit nga ana e aksionarëve është arsye e mjaftueshme për shkarkim.

Sfidat

Problemet e përgjithshme me të cilat është ballafaquar Sllovenia dhe të cilat janë të ngjashme me sfidat e ndërmarrjeve publike në Kosovë, janë:

Akumulim i humbjeve dhe rënie e vlerës së aseteve;

Humbjet dhe niveli i lartë i borxheve ka paraqitur rrezikun e mungesës së solvencës (insolvenca) me ndikim të drejtpërdrejtë në financat publike të shtetit;

Transferi i kapitalit në ndërmarrjet të cilat operojnë me humbje (ka kontribuar në deficitin buxhetor prej 6.4% të PBB në vitin 2011);

Garancionet shtetërore për ndërmarrjet publike kanë kontribuar në nivelin 25% të PBB (2011), etj.

Modeli i Kroacisë

Struktura menaxhuese

Kroacia ka strukturë dyshkallëshe të menaxhimit të ndërmarrjeve publike, përkatësisht Bordi Mbikëqyrës dhe Bordi Menaxhues. Bordi Menaxhues është përgjegjës për biznesin, si dhe drejtimin e ndërmarrjes me dilijencë.

Sfidat

Meqenëse edhe Kroacia është sfiduar me probleme të ngjashme sikurse vendet e tjera të cilat kanë inkorporuar parimet e ekonomisë së tregut, shteti ka ndërmarrë këto masa:

Inicimi i procesit të ristrukturimit dhe zgjidhjes së çështjes së obligimeve financiare të ndërmarrjeve publike nga fusha e transportit (rifinancimi, koncesionimi, etj).

Portugalia

Përzgjedhja e bordeve bëhet nga një komitet i pavarur (CReSAP), duke siguruar rritje të transparencës, paanësisë, saktësisë dhe pavarësisë në selektimin e kandidatëve për këto pozita.

Rumania

Sipas legjislacionit për ndërmarrjet publike, kërkohet një këshilltar i jashtëm i pavarur për të zhvilluar procesin e selektimit për drejtorët ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv. Kodet e qeverisjes në shtete tjera ndryshojnë në baza afatshkurtëra dhe afatmesme për shkak të përshtatshmërisë me realitetin e ndryshuar dhe ndryshimeve ekonomiko-sociale në vend.

Praktikat e shteteve të OBZHE:

Shtylla e transparencës dhe zbulimit të informatave është e ndërlikuar dhe çështje e ndjeshme për të gjitha ndërmarrjet publike moderne, andaj Ndërmarrjet në nivelin global zgjedhin që të zbulojnë sa më shumë informata mbi mënyrën se si operojnë, pasqyrat financiare, aspektet mjedisore dhe sociale të qeverisjes korporative në mënyrë që të fitojnë besimin e investitorëve dhe konsumatorëve apo klientëve të tyre. Ndër pikat kryesore të transparencës dhe udhëheqjes së qëndrueshme të ndërmarrjeve konsiderohen publikimi i integruar i raporteve/pasqyrave financiare si dhe raporteve narrative jo-financiare.

Në modelin e qeverisjes korporative të NP në shtetet tjera, Bordi i Ndërmarrjes ka rolin kryesor në sigurimin e pajtueshmërisë së udhëheqjes dhe operimit të kompanisë me kodin e qeverisjes korporative. Transparenca e Bordit të drejtoreve i cili vepron në emër të aksionarit, ekspozon Bordin ndaj rrezikut të përgjegjësisë për dështimin në monitorimin formal të kompanisë dhe gjithashtu inkurajon Bordin të përqendrohen në thelbin e praktikave të tyre të qeverisjes së korporatave. Në rast të mos-përmbushjes së obligimeve nga ana e Bordit, ose në rast të pakënaqësisë me Bordin, aksionari mund të ndërmarr masa korrigjuese/ndëshkuese të cilat duhet të saktësohen me Ligj.

Kodet e qeverisjes në shtete tjera ndryshojnë në baza afatshkurtëra dhe afatmesme për shkak të përshtatshmërisë me realitetin e ndryshuar dhe ndryshimeve ekonomiko-sociale në vend. Në Spanjë, Estoni, Lituani, Hungari, Ndërmarrjet janë të obliguara që në pjesë të veçantë të raportimeve, Annex apo në formë tabelare të publikojnë se si kanë përmbushur obligimet e dala nga kodi i qeverisjes korporative apo përshtatmërinë me kodin e qeverisjes së korporatave.

Kompanitë moderne konsiderohet se duhet të japin jo vetëm vlerë ekonomike në shoqëri por dhe vlera sociale dhe mjedisore. Përmbushja e këtyre tre kritereve konsiderohet qeverisje e përgjegjshme dhe e qëndrueshme korporative, praktike e mirë e cila kontribuon në rritjen e vlerës dhe reputacionit të kompanisë.

Suksesi i kompanisë poashtu varet nga aftësia e strukturave të brendshme për parashikimin dhe eliminimin e rreziqeve të parashikuara dhe humbjeve përmes iniciativave të përgjegjshme brenda kompanisë. Menaxhimi i riskut është parimi tjetër i

cili kontribuon llogaridhënies dhe i cili duhet përfshirë në raportimin vjetor se bashku me raportimin financiar dhe jo-financiar.

Një numër në rritje i studimeve tregojnë lidhje pozitive mes numrit më të madh të femrave në pozita të larta dhe performancën financiare të kompanive. Studiues të tjerë vënë në dukje se diversiteti më i madh është i lidhur me një dinamikë më të ndërlikuar të grupit në arritjen e konsensusit dhe se ka prirje më të larta nga udhëheqësi për të organizuar një diskutim efektiv.

Praktika të mira ndërkombëtare theksojnë shfrytëzimin e teknologjisë së re për ta forcuar llogaridhënien. Publikimi i të gjitha të dhënave përkatëse rregullisht në faqet e internetit të NP-ve dhe të kompanive tjera përkatëse, të cilat i zbatojnë kriteret për qeverisjen e korporatave, do ta rrit besimin e qytetarëve drejt shërbimeve të ofruara dhe besueshmërisë së kompanive.

Kapitulli 3

Synimet dhe Objektivat

Synimi

Synimi i përgjithshëm i kësaj politike është përmirësimi i performancës së ndërmarrjeve publike përmes menaxhimit më të mirëfilltë dhe proaktiv të Aksionarit, në harmoni me standardet e qeverisjes korporative të OBZHE-së, e cila do të rezultojë në rritje të vlerës së aseteve të NP-ve dhe ofrim të shërbimeve cilësore për publikun. Synim specifik i kësaj politike është heqja e hapësirave ligjore, dhe vënia në zbatueshmëri të dispozitave ligjore duke i konsoliduar ato me akte nënligjore si aktë përcjellëse.

Objektivat

Rol proaktiv dhe profesional i Aksionarit në udhëheqjen e qëndrueshme të NP me qëllim të ruajtjes së vlerës e tyre;

Fuqizimi i rolit monitorues të Aksionarit karshi NP-ve, në rritjen e aseteve publike dhe ofrimin të shërbimeve publike;

Rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së Bordeve në raport me Aksionarin;

Krijimi i politikave të qëndrueshme ekonomike të cilat mundesojnë rritjen e vleres së aksioneve;

Sigurimi i kthimit të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm financiar i NP, duke mbajtur në nivel të arsyeshëm rrezikun financiar.

Rritja e kontributit të NP në vlerat socio-ekonomike dhe mjedisore të shtetit.

Kapitulli 4

Opsionet:

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Korniza aktuale ligjore në fushën e Ndërmarrjeve Publike në rast të mos hartimit të politikës së re për Ndërmarrjet Publike, do të vazhdonte me sfida dhe paqartësi juridike. Gjithashtu, kjo situatë pamundëson harmonizimin me praktikatat më të mira të OBZHE.

Opsioni status quo në lidhje me funksionimin e ndërmarrjeve publike, mund të rezultojë me rënien e vlerës së përgjithshme të asetëve në pronësi publike. Rrjedhimisht, kjo situatë e mundshme në lidhje me asetet publike mund të rrezikojë seriozisht cilësinë e shërbimeve të cilat u ofrohen qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për më shumë, mungesa e politikës së përgjithshme publike në lidhje me orientimin strategjik për zhvillimin dhe organizimin e ndërmarrjeve publike në treg, mund të ketë pasoja negative në ekonominë e vendit.

Në anën tjetër, mos reformimi i strukturës organizative të ndërmarrjeve publike pamundëson funksionimin efektiv dhe efikas të tyre.

Mungesa e integritit të plotë të parimeve të qeverisjes korporative në aktet normative dhe zbatimin e tyre në organizatë, konsiston me mungesë të përgjegjësisë, ndarjes së përgjegjësisë, llogaridhënies dhe kontrollit.

Gjendja aktuale e raportimit nga ana e ndërmarrjeve publike ka pamundësuar përcjelljen e arritjes së objektivave dhe veprimeve përkatëse të organizatës.

Mungesa e identifikimit paraprak të rreziqeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe në anën tjetër parashikimi i instrumenteve për parandalimin e pasojave eventuale në nivel të ndërmarrjes, ka shkaktuar mos arritjen e qëllimeve në lidhje me projektet e planifikuara.

Mungesa e sanksioneve në lidhje me mos zbatimin e legjislacionit në fuqi paraqet hendek në mes të obligimeve ligjore, zbatimit të tyre dhe ndërkohërisht në rast të veprimeve

kundërligjore. Si rezultat, këto veprime ndikojnë në thellimin e përgjegjësisë, neglizhencës dhe mungesës së veprimit sipas kompetencave ligjore.

Niveli jo i kënaqshëm i transparencës në vendimmarrje dhe llogaridhënies, krijon mungesë të besimit nga ana e aksionarit, grupeve të interesit dhe qytetareve në përgjithësi. Ndërmarrjet në pronësi publike duhet të përmirësojnë nivelin aktual të transparencës, në kuptim të publikimit të të dhënave me interes publik.

Mungesa e kompetencave të plota ligjore dhe instrumenteve përkatëse me qëllim të monitorimit të performancës së ndërmarrjeve publike, ka ndikuar në krijimin e situatës aktuale sipas së cilës operojnë ndërmarrjet publike.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Gjendja ekzistuese duhet të ndryshohet me hartimin e kuadrin Ligjor primar dhe sekondar për Ndërmarrjet Publike përmes së cilit mund të rregullohen qartë përgjegjësitë dhe pengesat e secilit mekanizëm në ushtrimin e të drejtës pronësore.

Qëllimi parësor i ndryshimit të politikës ekzistuese është ndryshimi i përgjegjësive dhe autorizimeve me qëllim të fuqizimit dhe rritjes së rolit monitorues të Aksionarit karshi NP-ve, si dhe adresimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së Bordeve të Drejtorëve ndaj Aksionarit dhe palëve tjera të interesit.

Politika e rekomanduar konsiston në këto ndryshime kryesore:

- Me propozim të Qeverisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës të miratojë politikën pronësore për menaxhimin e aseteve shtetërore, si politika orientuese strategjike të cilat do të ndikojnë në funksionimin me efektiv të Ndërmarrjeve Publike;
- Roli i aksionarit duhet fuqizuar përmes ligjit të ri, përkatësisht qasjes më proaktive në vendimmarrje dhe në monitorim, në pajtim me objektivat strategjike të NP-ve;
- Mekanizmi i monitorimit të ndërmarrjeve publike nga ana e aksionarit, duhet të fuqizohet me ndryshimet në legjislacionin e ri. Ndryshimet do të konsistojnë në strukturë, dhënie e autorizimeve, si dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore brenda vetë mekanizmit monitorues;
- Zbatimi i parimeve të Qeverisjes Korporative sipas OBZHE-së ose aplikimi i modelit Britanik “comply or explain” në rast të mos zbatimit të parimeve të Qeverisjes Korporative.

- Mënyra e përzgjedhjes së bordit të drejtorëve qoftë bordit mbikëqyrës dhe atij menaxhues, duhet të zhvillohet në përputhje të plotë me parimet e qeverisjes korporative të OBZHE-së. Ligji i ri për ndërmarrjet publike duhet të parasheh në mënyrë decisive kriteret, kualifikimet dhe përgjegjësitë në ushtrimin e kompetencave të tyre;

- Procedura e shkarkimit të bordeve të drejtorëve dhe atij menaxhues, përfshirë edhe zyrtaret e lartë të ndërmarrjeve publike, duhet të ndryshohet me Ligjin e ri për ndërmarrjet publike;

- Monitorimi i performancës së ndërmarrjeve publike duhet të rregullohet bazuar në sistemin e krijuar për monitorim të performancës që do të përfshinte këta hapa: Përcaktimi i objektivave për monitorim të performancës, marrja e informatave bazë për Ndërmarrjet Publike, përcaktimi i mandatit (misionit), strategjive dhe objektivave, strukturimi i marrëveshjeve për matje të performancës, zhvillimi i indikatorëve kyç të performancës dhe vendosja e caqeve.

Rekomandohet që të zgjidhen indikatorët të cilët tregojnë vlerën e vërtetë të Ndërmarrjes, të mos krijohet konfuzion i tepruar dhe të tentohet të matën vlerat që janë shpesh herë të pamatshme në vend që të krijojnë pasqyrë të qartë për gjendjen dhe të ardhmen e NP-ve. Indikatorët dhe masat e ndërmarrja duhet që të krijojnë incentiva për përmirësime dhe të ndikojnë pozitivisht në performancën e NP-ve.

- Standardizimi i procedurës së raportimit në pajtueshmëri me Ligjin për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim në fuqi, është parakusht për vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe rritjes së përgjegjësisë në raport me aksionarin dhe grupet e tjera të interesit.

- Përmes dispozitave ligjore të fuqizohet llogaridhënia në dy nivelet e bordeve drejtues, sepse kjo do të mundëson mbajtjen e përgjegjshmërisë për caqet e caktuara nga nivelet e larta brenda apo jashtë ndërmarrjeve publike. Poashtu, llogaridhënia mundëson përshtatjen dhe marrjen e vendimeve me kohë për të eliminuar rreziqet apo pengesat në arritjen e planeve dhe objektivave të caktuara (përmirësimi i kualitetit në vendimmarrje);

- Politika e kompensimit për NP, përkatësisht për bordin e drejtorëve dhe atë menaxhues, si dhe stafin e brendshëm të NP-ve, duhet të jetë në diskrecion të plotë të aksionarit sipas objektivave. Kjo politikë duhet të jetë e harmonizuar sipas vlerës së NP në treg, si dhe rëndësisë së ofrimit të shërbimeve/produkteve (politikat e stimujve sipas kompanive);

- Miratimi dhe çdo ndryshim dhe plotësim i Statutit, duhet të bëhet me miratim paraprak nga ana e aksionarit në mbledhjet vjetore;

- Cilësia e shërbimeve të ofruara nga NP-të, përpos që duhet të jetë obligim ligjor për Ndërmarrjet Publike, duhet të synojë standardizimin dhe vlerësim objektiv në lidhje me

shërbimet e ofruara. Raportet e rregullta vjetore të standardizuara në lidhje me matjen e kënaqshmerisë së shërbimeve të ofruara, duhet të vlerësohen nga ana e Aksionarit, përmes së cilës do të matet edhe performanca e Bordeve;

- Menaxhimi i rrezikut duhet të jetë ndër shtyllat kryesore të raportimit të NP. Përpos raporteve tjera vjetore financiare dhe jo-financiare, NP duhet të përfshijë planin mbi menaxhimin e rrezikut i cili do të përmbantë në vete ciklin si identifikimi i rreziqeve, vlerësimi i efekteve të rreziqeve, interpretimi i rezultateve të vlerësimit të rrezikut, veprimet për zvogëlim të rrezikut dhe monitorimi i implementimit të sistemit të kontrollit të rrezikut. Plani i hartuar vjetor për menaxhimin e rrezikut duhet vlerësuar dhe miratuar në fund të vitit nga aksionari. Mekanizmi monitorues nga ana e aksionarit do të monitorojë në mënyrë specifike menaxhimin e rrezikut për secilën NP.

- Të parashihen dispozitat sanksionuese, duke përfshirë masat korrigjuese dhe masat ndëshkuese, mënyrat dhe format e sanksionimit, si dhe afatet kohore për marrjen e vendimit për shqiptimin e sanksionit nga ana e Aksionarit;

- Qartësimi i procedurave dhe kritereve në themelim të NP Qendrore dhe Lokale dhe mënyra e mbikëqyrjes së tyre nga ana e Aksionarit.

- Autoriteti i Njësisë për Monitorimin e NP duhet të fuqizohet me dispozita sanksionuese për rastet kur nuk merren parasysh shkresat zyrtare të kësaj Njësie. Poashtu autoriteti i këtij entiteti në të ardhmen do të fuqizohet përmes dispozitave ligjore të cilat mundësojnë rritjen e kapaciteteve dhe përgjegjësiive karshi NP-ve.

Përgjegjës për hartim dhe zbatim të politikave dhe akteve normative është Qeveria (Aksionari) dhe MZHE. Në emër të Aksionarit përmes mekanizmit monitorues ndaj NP-ve vepron MZHE.

Ky ligj do të zbatohet edhe nga ana e Ndërmarrjeve Publike Qendrore dhe Lokale si dhe akterët tjerë si palë të treta.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Opsioni i tretë nuk mund të zbatohet sepse politika ekzistuese në fuqi, përveq tjerash, nuk parashihet orientimin strategjik në lidhje me asetet në pronësi publik dhe orientimin strategjik për përmbushjen e ofrimit të shërbimeve cilësore. Për më tepër, korniza ligjore në fuqi aktualisht, përmban shumë hapësira si dhe nuk i parashihet disa nga qështjet thelbësore për funksionimin e NP-ve dhe funksionimin e kompetencave të Aksionarit karshi NP-ve.

Kapitulli 5

Përmbledhja e Opsioneve

Në vijim paraqesim tabelën me opsionet e përmbledhura:

Përmbledhja e opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
<i>Karakteristikat kryesore të opsionit</i>			
<i>Segmenti i popullsisë /sektori/rajoni i shënjestruar</i>			
<i>Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët</i>			
<i>Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit</i>			
<i>Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e</i>			

<i>ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet</i>			
<i>Stimulimet ose mos- stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat</i>			
<i>Fushatat e edukimit dhe komunikimit</i>			
<i>Udhëzimet</i>			
<i>Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni</i>			

Kapitulli 6

Analiza e opsioneve

Përfitimet

Përfitimet e Opsionit 1: (Status quo)

Ky opsion nuk parasheh arritjen e përfitimeve përmes mbajtjes së gjendjes ekzistuese. Korniza ligjore në fuqi pamundëson funksionimin e ndërmarrjeve publike, realizimin e qëllimeve, si dhe përmbushjen e detyrave në lidhje me ofrimin e shërbimeve cilësore publike dhe mbajtjes së pronësisë publike.

Përfitimet e Opsionit 2: (REKOMANDUAR)

Hartimi i kornizës së re ligjore primare dhe sekondare, mundëson definimin e detyrave dhe përgjegjësi të mekanizmave që e ushtrojnë këtë të drejtë dhe ngritjen e nivelit të llogaridhënies lidhur me performancën e NP-ve. Hartimi i Ligjit të ri dhe akteve nënligjore të reja, mundëson harmonizimin e planeve të bizneseve të ndërmarrjeve me politikën e përgjithshme zhvillimore dhe ato sektoriale, mundëson rritjen e efikasitetit dhe kualitetit në qeverisje të Ndërmarrjeve Publike, mundëson arritjen e nivelit më të lartë të transparencës së Ndërmarrjeve Publike si dhe mundëson rritjen e nivelit të besueshmërisë më të lartë të konsumatorëve/ klientëve.

Përmirësimi i llogaridhënies ndihmon në arritjen dhe matjen e progresit, sepse në vazhdimësi Ndërmarrja Publike i vlerëson rezultatet dhe progresin e arritur në fazat e caktuara. Si rezultat i përzgjedhjes së opsionit të rekomanduar, përfitimet në lidhje me pronësinë publike kontribuojnë në arritjen e vizionit strategjik të secilës Ndërmarrje Publike.

Përfitimet e opsionit 3:

Mungesa e dispozitave zbatuese të legjislacionit aktual në fuqi, pamundësojnë implementimin e suksesshëm të këtij opsioni. Si rezultat, ndryshimi i instrumenteve zbatuese të legjislacionit në këtë fushë nuk kontribuon pozitivisht në procesin e përmirësimit të gjendjes ekzistuese në lidhje me NP, për arsye të mungesës të vet dispozitave në kuadër të kornizës ligjore.

Pasojat negative të opsionit 1 (Status Quo)

Vazhdimi i gjendjes ekzistuese mund të ndikoj negativisht jo vetëm në performancën e ndërmarrjeve publike dhe vlerën e aseteve në pronësi publike, por edhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

Pasojat negative për opsionin e dytë

Nuk ka pasoja negative.

Pasojat negative për opsionin e tretë

Zbatimi i legjislacionit në përgjithësi është i mangët në mungesë të dispozitave të qarta ligjore brenda legjislacionit ekzistues. Kjo pamundëson zbatimin e suksesshëm edhe në rast të ridizajnit të mekanizmave për zbatim të legjislacionit ekzistues.

Efekti shpërndarës

Si rezultat i ndryshimit të legjislacionit për ndërmarrjet publike, efekti do të paraqitet në të gjithë sektorët në të cilët operojnë ndërmarrjet publike, përkatësisht në sektorin e energjisë, minierave, telekomunikacionit, shërbimeve postare, mbeturina, ujit, etj.

Në anën tjetër, efekti do të paraqitet edhe në kuptimin e financave publike, përkatësisht reduktimit gradual të implikimeve buxhetore për përkrahje financiare të ndërmarrjeve publike.

Kosto

Tabela më poshtë përmban koston vjetore të shërbimeve, për zbatimin e ligjit:

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0
Opsioni 2				

Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0

Kapitulli 7

Konsultimi

Bazuar në Rregulloren Nr.09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Qeverisë së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 05/2016 për Standartet Minimale për Procesin e Konsultimeve Publike, është zhvilluar procesi i konsultimeve paraprake dhe publike. Drafti është dërguar për konsultim tek institucionet si: ZKM, SKQ, MF, MIE, MAPL, MMPH, MI, MD, MAP, Asociacioni i Komunave, OSCE etj. nga data 23.05.2017 deri me datë: 13.06.2017.

Komente kemi pranuar nga institucionet si: **Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, Sekretariati Kordinues i Qeverisë, Ministria e Administratës Publike, KRU "Hidromorava"-sha në Gjilan, IFC, Zyra e BE-së, Aeroporti i Gjakoves.**

Poashtu janë mbajtur takime me gjitha palët që kanë kontribuar në draft si me ekspertet e IFC-së, Asociacionin e Komunave, Ministrinë e Administratës Publike dhe janë ofruar gjitha sqarimet e nevojshme.

Gjitha komentet e pranuar gjatë procesit të konsultimeve janë shqyrtuar dhe janë bërë pjesë e Koncept Dokumentit. Poashtu gjitha komentet e pranuar janë paraqitur në Raport

ku janë dhënë në formë të detajuar informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara.

Kapitulli 8

Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1, Status Quo (asnjë ndryshim), sipas vlerësimit ndikon negativisht në trendet e performancës së Ndërmarrjeve Publike, përkatësisht rënies së vlerës së aseteve dhe rënies së kualitetit të shërbimeve/ produkteve të ofruara.

Opsioni 2, Hartimi i Ligjit të ri mundëson harmonizimin e planeve të bizneseve të ndërmarrjeve me politikat e përgjithshme zhvillimore dhe ato sektoriale; rritjen e efikasitetit dhe kualitetit në qeverisje të Ndërmarrjeve Publike; arritja e nivelit më të lartë të transparencës së Ndërmarrjeve Publike mundëson rritjen e nivelit të besueshmërisë më të lartë të konsumatorëve/ klientëve.

Opsioni 3. Me ligjin aktual, si dhe aktet nënligjore në fuqi, nuk ka mundësi të bëhet qasje e re e zbatimit.

Kapitulli 9

Rekomandimi

Në bazë të analizës gjithëpërfshirëse të legjislacionit ekzistues të Ligjit Nr. 03/L-087 për NP, Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për NP të vitit 2012, si dhe Ligjit Nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për NP i ndryshuar dhe plotësuar me Ligj Nr. 04/L-111 të vitit 2015, rekomandojmë Qeverisë së Republikës së Kosovës miratimin e opsionit 2 të propozuar në këtë Koncept Dokument, përkatësisht opsionin e rekomanduar për hartimin e Ligjit të ri për Ndërmarrjet Publike. Qeveria e Republikës së Kosovës rekomandohet që të aprovoj si të tillë propozimin e dytë pasi që përmes ndryshimit të politikës ekzistuese do të bëhet rritja e përgjegjësisë, kapaciteteve dhe autorizimeve të etnitetit monitorues, me qëllim të fuqizimit dhe rritjes së rolit të Aksionarit karshi NP-ve. Ndryshimi i politikës ekzistuese synon adresimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së Bordit të Drejtorëve ndaj Aksionarit dhe palëve tjera të interesit si dhe krijimi i politikave të qëndrueshme ekonomike të cilat mundësojnë rritjen e vlerës së aksioneve të NP-ve.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik do të dorëzojë në Qeverinë e Republikës së Kosovës këtë Koncept dokument për miratim deri në muajin Dhjetor 2017. Kostoja e vlerësuar e këtij Koncept Dokumenti nga Ministria e Financave është në vlerën prej €. Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Zhvillimit Ekonomik do të fillojë

procesin e hartimit të ligjit për Ndërmarrjet Publike konform Rregulloreve të Qeverisë për procedura të hartimit të akteve normative dhe shërbimeve ligjore.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik do të dorëzojë në Qeverinë e Republikës së Kosovës projektligjin për Ndërmarrjet Publike deri në K4 2018.

Kapitulli 10

Komunikimi

Ministria e Zhvillimit Ekonomik do të jetë e përqendruar në komunikimin e kësaj politike me organet e administratës publike por edhe me publikun e gjerë në ofrimin e informacioneve lidhur me detajet e procesit të hartimit të Projektligjit për Ndërmarrjet Publike përmes një procesi të hapur të komunikimit dhe shkëmbimit të informatave, duke marrë parasysh të gjitha propozimet e akterëve të ndryshëm relevant, konsultimet me ekspertët në fushën e caktuar, si dhe konsultimi me shoqërinë civile.

Komunikimi do mundësohet përmes formave të ndryshme, si: takimet gjithëpërfshirëse dhe takimet e veçanta me grupe të interesit, publikimet në ueb faqen zyrtare të MZHE-së, pastaj përmes platformës së konsultimit publik, mediat e shkruara dhe elektronike, organizimi i tyezave dhe tubimeve publike, etj.